

deklarata H.B, FDH-33489; fotografi, FDH-18806; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

Agim (Binak) Qelaj

(6.12.1961, shqiptar nga Peja/Peć, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Gëzim (Salih) Hamza - Piktori

(5.10.1963, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, pjesëtar i UÇK-së)

Liman (Destan) Gegaj

(30.10.1965, shqiptar nga Novosella/Novo Selo, Malishevë/Mališevo, pjesëtar i UÇK-së)

Sadik (Hafir) Shala

(17.04.1966, shqiptar nga Kleçka/Klečka, komuna e Lipjanit/Lipljan, pjesëtar i UÇK-së)

Faik (Hajredin) Rama

(10.01.1972, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, agronom, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Para fillimit të luftës, Gëzimi ka jetuar në Rovinj [Kroaci]. Ka marr pjesë në luftën e Kroacisë. Ishte në krye të njësiteve që kanë hyrë në Rahovec/Orahovac më 17.07.1997. Agimi me bashkëshorten dhe tre fëmijët kanë jetuar në Gjermani deri në vitin 1998, kur ai u kthye në Kosovë dhe aderoi në radhët e UÇK-së. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e ka dërguar Agimin në Rahovec/Orahovac, për të vlerësuar shkallën e organizimit të njësiteve të UÇK-së në terren. Gjatë zbatimit të kësaj detyre, ai rastisi të jetë i pranishëm kur forcat e UÇK-së e nisën sulmin mbi Rahovecin/Orahovac. Sadikun e kanë arrestuar dhe dënuar në muajin janar të vitit 1997, për shkak të lidhjeve me UÇK-në. E liruan nga burgu në muajin qershor të vitit 1997. Një vjet më vonë, në muajin qershor të vitit 1998, ai aderoi në radhët e UÇK-së. Ka qenë bashkëpunëtor i ngushtë i Fatmir Limajt. Faiku ishte student i agronomisë në Universitetin e Prishtinës/Priştina. Së bashku me vëllain Beharin kanë aderuar në UÇK në muajin prill të vitit 1998. Në fillim punonte në administratë dhe logjistikë. Pas themelimit të batalionit të Rahovecit/Orahovac, ai kaloi në këtë zonë operative, e cila ishte nën komandën e Gëzim Hamzes.

Në datën **19.07.1998**, Gëzim Hamza

gjendej afër pikës së karburanteve *Jaha Petrol* [Rahovec/Orahovac], kur e ka qëlluar predha që u shkrep nga drejtimi i Xërxës/Zrre, ku ishin të pozicionuara njësitet e Brigadës së 549 të Motorizuar të Ushtrisë së Jugosllavisë. Nderroi jetë menjëherë nga lëndimet e rënda. Po atë ditë, në luftimet që u zhvilluan në dalje të Rahovecit/Orahovac në drejtim të Gjakovës/Đakovica, vdekjen e gjetën Agimi, Sadiku, Faiku dhe Limani.

Gëzimin e kanë varrosur së pari në periferi të qytetit, ndërkaq pas përfundimit të luftës, atë e rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Rahovec/Orahovac. Policia serbe e ka varrosur Sadikun në varrezat e Prizrenit/Prizren. Në datën 26.07.1998, ushtarë të UÇK-së e bartën kufomën e Sadikut në varrezat e fshatit Kleçkë/Klečka. Pas përfundimit të luftës, në muajin gusht të vitit 2001, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Kleçkë/Klečka. Mbetjet mortore të Agimit u identifikuan më 5.12.2007 dhe ato u varrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Kleçkë/Klečka më 18.12.2008. Mbetjet mortore të Agimit u zbuluan në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac më 16.06.2007. Mbetjet mortore të Faikut u identifikuan më 1.04.2005, kur edhe u varrosën në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac. Ato u zbuluan në fushën e quajtur *Rimnik*, në afërsi të lumit. Trupi i Limanit ende nuk është zbuluar. Emri i tij gjendet në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së dhe lënda e tij e mban numrin BLG-804810-01.

Burimet: deklarata A.S, FDH-11600; deklarata B.Q, FDH-15090; deklarata J.K, FDH-18409; deklarata Sh.V, FDH-33474; deklarata B.K, FDH-34649; SHFUDUÇK, *Feniksët...3*, 163-166; SHFUDUÇK, *Feniksët...7*, 91-95; SHFUDUÇK, *Feniksët...5*, 95-100; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 121, FDH-23857; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; *Liman Gegaj*, pasqyra e lajmeve, Sabahudin Cena, http://rahoveci.net/modules/newbb/viewtopic.php?topic_id=398&forum=4FDH-34668;KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; fotografi, FDH-21029.